

VENDIM
Nr. 616, datë 22.9.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 404, DATË 20.6.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË KRITEREVE E TË PROCEDURAVE TË PËRFITIMIT TË KOMPENSIMIT FINANCIAR, NGA PERSONAT ME STATUSIN E TË VERBRIT DHE INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK, PËR FATURËN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE FATURËN E TELEFONISË FIKSE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 12, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 404, datë 20.6.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikat 1 dhe 2, fjalët “... 2 000 (dy mijë) lekë në muaj...” zëvendësohen me “..... 3 000 (tre mijë) lekë në muaj...”.

2. Në pikën 3 të vendimit fjalët “... 1 400 (një mijë e katërqind) lekë në muaj ...” zëvendësohen me “... 2 400 (dy mijë e katërqind) lekë në muaj ...”.

3. Kudo në vendim, emërtimet “Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” dhe “Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” zëvendësohen, përkatësisht, me “Ministri përgjegjës për çështjet sociale” dhe “Ministria përgjegjëse për çështjet sociale”.

4. Ngarkohen Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 tetor 2022 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku